



REPUBLIKAE SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE SOCIALE, E ARSIMIT DHE E RINISË

Nr. 4537 prot.

Himarë, më 19.06.2026

**Lënda:** Dërgohet për miratimin e ndryshimit të destinacionit të pjesës së papërdorur të fondit të programit të shërbimit lëvizës social.

**KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË** ✓

Po ju dërgojmë për miratim projektvendimin për miratimin e ndryshimit të destinacionit të pjesës së papërdorur të fondit të programit të shërbimit lëvizës social.

Bashkëngjitur projektvendimi dhe relacioni sqarues për këtë projektvendim.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

**KRYETARI I BASHKISË**

**Vangjel Tavo**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
KRYETARI

Nr. 1537/prot.

Himarë, më 19.06.2026

**PROJEKTVENDIM**

Nr. 37, datë 19.06.2026

**“PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË DESTINACIONIT TË PJESËS SË  
PAPËRDORUR TË FONDIT TË PROGRAMIT TË SHËRBIMIT LËVIZËS  
SOCIAL”**

Në mbështetje të nenit 54, shkronja “dh”, dhe nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 1446, datë 11.02.2026, ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Himarë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë ndryshimin e destinacionit të pjesës së papërdorur të fondit të akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të programit të Shërbimit Lëvizës Social, për periudhën janar 2026 – qershor 2026, e krijuar si rezultat i mosrealizimit të plotë të shpenzimeve për pagesat e specialistëve të programit.

2. Të miratojë përdorimin e fondit të papërdorur të parashikuar për pagesat e specialistëve (psikolog, fizioterapist dhe koordinator programi) për financimin e shërbimeve mbështetëse të përfituesve të programit, konkretisht:

- sigurimin e pakove ushqimore;
- sigurimin e medikamenteve;
- mbulimin e nevojave të tjera të domosdoshme të përcaktuara në planin individual të ndërhyrjes së përfituesve të Shërbimit Lëvizës Social, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

3. Drejtoria e financës, parashikimit të buxhetit dhe menaxhimit të asetëve dhe Drejtoria e çështjeve sociale, e arsimit dhe e rinisë ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

**KRYETARI I BASHKISË**

**Vangjel Tavo**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE SOCIALE, E ARSIMIT DHE E RINISË

Nr. 4537/prot.  
/2

Himarë, më 19.06.2026

### RELACION SQARUES

**Lënda:** Për miratimin e ndryshimit të destinacionit të pjesës së papërdorur të fondit të programit të shërbimit lëvizës social

### KËSHILLIT BASHKIAK

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr. 121/2016 “Për Shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. prot. 1446, datë 11.02.2026, të lidhur ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Himarë për financimin e programit të Shërbimit Lëvizës Social.

Qëllimi i këtij relacioni është paraqitja për miratim në Këshillin Bashkiak e kërkesës për ndryshimin e destinacionit të një pjese të fondit të akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror, për zbatimin e programit të Shërbimit Lëvizës Social në Bashkinë Himarë. Në kuadër të këtij programi, Shërbimi Social Shtetëror ka transferuar në buxhetin e Bashkisë Himarë fondin në vlerën **3,479,080 (tre milionë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e tetëdhjetë) lekë**, me qëllim mbështetjen e ofrimit të shërbimeve sociale për grupet në nevojë në territorin e bashkisë. Sipas nenit 4 të marrëveshjes së sipërcituar, fondi i akorduar është parashikuar të përdoret për mbulimin e shpenzimeve të personelit të specializuar të angazhuar në program, konkretisht për pozicionet e psikologut, fizioterapistit dhe koordinatorit të programit. Gjatë periudhës së zbatimit të programit, Bashkia Himarë ka ndërmarrë procedurat e nevojshme për identifikimin, rekrutimin dhe angazhimin e specialistëve të kërkuar nga projekti. Megjithatë, për shkak të karakteristikave demografike të territorit, mungesës së profesionistëve të specializuar në zonë, si dhe vështirësive objektive në tërheqjen dhe punësimin e tyre, procesi i plotësimit të këtyre pozicioneve nuk ka rezultuar i suksesshëm në masën e parashikuar.

Si pasojë, një pjesë e fondit të destinuar për pagesat e specialistëve nuk është përdorur gjatë periudhës **janar 2026 – qershor 2026**, duke krijuar një fond të papërdorur, ndërkohë që nevojat sociale të familjeve dhe individëve përfitues të programit vazhdojnë të jenë të larta. Nga monitorimi i rasteve të trajtuara nga strukturat sociale të Bashkisë Himarë rezulton se një pjesë e konsiderueshme e përfituesve të shërbimit kanë nevoja të menjëhershme për mbështetje me pako ushqimore dhe medikamente, të cilat janë elementë të parashikuar dhe të pranueshëm në kuadër të paketës së ndërhyrjeve të Shërbimit Lëvizës Social për grupet vulnerabël. Duke marrë në konsideratë:

- pamundësinë objektive për të realizuar në kohë të plotë rekrutimin e specialistëve të parashikuar;
- nevojën për përdorimin efektiv dhe në interes të drejtpërdrejtë të komunitetit të fondit të akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- faktin se Bashkia Himarë mbetet e angazhuar për të siguruar personelin e nevojshëm dhe për të vijuar pagesën e tij nga fondet e alokuara në momentin e plotësimit të pozicioneve;
- nevojat konkrete dhe të dokumentuara të përfituesve të programit për mbështetje ushqimore dhe medikamente;

Nisur nga kjo situatë propozohet ndryshimi i një prej pikave të nenit 4 të Marrëveshjes nr. 1446, datë 11.02.2026, duke lejuar që fondi i papërdorur nga pagesat e specialistëve për periudhën janar–qershor 2026 të përdoret për financimin e pakove ushqimore dhe medikamenteve për përfituesit e programit të Shërbimit Lëvizës Social. Ky ndryshim nuk cenon objektivat e programit dhe as destinacionin social të fondit, por garanton përdorimin e tij në funksion të përmbushjes së nevojave prioritare të qytetarëve në nevojë. Bashkëlidhur do të gjeni marrëveshjen e bashkëpunimit mes Bashkisë Himarë dhe Shërbimit Sociale Shtetëror si dhe shkresën e shpalljes së fituesit.

Për sa më sipër, kërkohet miratimi nga Këshilli Bashkiak Himarë bazuar në kërkesat e nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar, i ndryshimit, të destinacionit të fondit të papërdorur për pagesat e specialistëve gjatë periudhës janar–qershor 2026, duke e orientuar atë drejt mbulimit të shpenzimeve për **pako ushqimore dhe medikamente**, si pjesë përbërëse e programit të Shërbimit Lëvizës Social, si dhe autorizimi i Kryetarit të Bashkisë për të ndjekur procedurat administrative dhe institucionale për realizimin e këtij ndryshimi pranë institucioneve përgjegjëse.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

**KRYETARI I BASHKISË**

Vangjel Tavo

DREJTOR  
Aida Halilaj

DREJTORI JURIDIK  
Ardit Muhametaj

DREJTORI I FINANCËS, PARASHIKIMIT TË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT TË ASETËVE

Besa Xhaferri

